



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR			
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA			
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING			
Mjedisit Org. Org. Jedinica Org. Unit	SP-02	Nr. Prot. Broj. Prot. Prot. No.	755-2/26
Nr. i faqeve Broj. stranica No. pages	- 06 -	Data: Datum: Date:	12.08.2020
PRISHTINË/A			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	01.06.2026
REFERENC-Ë:	26/755/114/DMM
PËR/ZA/TO:	"Shalaj" Sh.p.k Zallç, Istog
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 26/755/114/DMM dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për Kompaninë "Shalaj" Sh.p.k Zallç, Istog, me nr. prot.: 26/755/114/DMM, për Fabrikën e prodhimit të kabëzave dhe produkteve nga betoni linja 1 dhe linja 2 dhe impianti i riciklimit të mbetjeve nga produktet e betonit, në ngastrat kadastrale nr. P-70806017-00971-1 dhe P-70806017-00971-2, Z.K Zallç, Istog .

2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,

Faqe 1 nga 6

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja " kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmphi>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Shtetërore, duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit Nr.08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, mbështetur në mendimin profesional të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Vendimi Nr.3958-4/23 datë 21.04.2026), në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Kompania "Shalaj" Sh.p.k Zallç, Istog, me nr. prot.: 26/755/114/DMM, **pajiset me Pëlqim Mjedisor** për Fabrikën e prodhimit të kabëzave dhe produkteve nga betoni linja 1 dhe linja 2 dhe impianti i riciklimit të mbetjeve nga produktet e betonit, në ngastrat kadastrale nr. P-70806017-00971-1 dhe P-70806017-00971-2, Z.K Zallç, Istog, nën kushtet si vijon:

-Aktiviteti të zhvillohet vetëm brenda parcelave dhe kapaciteteve të aprovuara me këtë Pëlqim Mjedisor.


-Të ndërmerren masa për parandalimin dhe reduktimin e emetimeve të pluhurit gjatë proceseve të prodhimit, ngarkim-shkarkimit, transportit dhe riciklimit të materialeve.

Faqe 2 nga 6

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja " kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmphi>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net





-Operatori të sigurojë pajisje dhe mjete për reagim në raste aksidentale, rrjedhjesh ose incidenteve mjedisore.

-Të hartohet dhe zbatohet plani për menaxhimin e emergjencave mjedisore.

-Të kryhet monitorimi periodik i emetimeve në ajër, cilësisë së ujërave të shkarkuara dhe nivelit të zhurmës, sipas kërkesave ligjore.

-Rezultatet e monitorimit të ruhen dhe të vihen në dispozicion të autoriteteve kompetente sipas kërkesës.

-Operatori është i obliguar të njoftojë menjëherë Ministrinë dhe institucionet tjera kompetente për çdo aksident apo ndotje që mund të shkaktojë ndikim në mjedis.

-Të sigurohen kushte për gjelbërimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të lira brenda kompleksit, sipas mundësive teknike të lokacionit.

-Çdo ndryshim i teknologjisë, kapaciteteve prodhuese, lëndëve të para ose zgjerim i aktivitetit duhet të paraqitet paraprakisht për shqyrtim nga autoriteti kompetent.

-Operatori është i obliguar të sigurojë dhe të respektojë të gjitha lejet, pëlqimet dhe autorizimet e tjera të kërkuara sipas legjislacionit në fuqi.

-Operatori është i obliguar të zbatojë të gjitha masat mbrojtëse dhe monitoruese të parapara në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)

Nëse nuk plotësohen kushtet e lartcekura, pëlqimi do të anulohet (revokohet).

Ar sy e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor nga Komisioni për VNM, dokumentacionin përcjellës të dorëzuar nga Kompania "Shalaj" Sh.p.k. Istog, me nr. prot.: 26/755/114/DMM, të datës 20.02.2026 , për Pëlqim Mjedisor Fabrikën e prodhimit të kabëzave dhe produkteve nga betoni linja 1 dhe linja 2 dhe impianti i riciklimit të mbetjeve nga produktet e betonit, , në ngastrat kadastrale nr. P-70806017-00971-1 dhe P-70806017-00971-2, Z.K Zallç, Istog, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nxjerrë Vendim për **lëshuarjen e Pëlqimit Mjedisor**.

Ky Pëlqim Mjedisor lëshohet konform nenit 29 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181

Faqe 4 nga 6

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja " kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmphi>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore

Ky Pëlqim Mjedisor vlen dy vite konform nenit 21 te Ligjit për VNM 08/L-181.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Vërejtje: Vonesa në dhënien e përgjigjes është shkaktuar si rezultat i volumit të madh të kërkesave në procedurë dhe ndryshimit të përbërjes së Komisionit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM). Informohet se shqyrtimi i lëndës deri në fazën e mbajtjes së debatit publik është kryer nga Komisioni paraprak.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 26/755/-ZSP/ /26 datë: 01.06.2026

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. AMMK-së
5. Kabinetit të Ministrit
6. Komunës së Istogut
7. Divizionit për komunikim me publikun
8. Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore
9. Arkivit të MMPHI



Bajram Kafexholli

UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH

